

## NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA THEMELORE PRISHTINË-DEGA PODUJEVË, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Penal**, me gjyqtarin e vetëm gjykues Minir Hoti, dhe sekretaren juridike Fatmire Podvorica, në çështjen penale kundër të pandehurit S. H. M. nga fshati P., Komuna e P., për shkak të veprës penale Vjedhje pylli nga neni 358 par.2 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Publike Komunale tani Prokuroria Themelore në Prishtinë PP.nr.1881/2011 të dt.21.06.2012, në shqyrtimin gjyqësor publik të mbajtur në praninë e Prokurorit të Shtetit Enver Krasniqi nga Prokuroria Themelore në Prishtinë, përfaqësuesit të të dëmtuarës Faik Rama dhe të pandehurit S. M., pas përfundimit të shqyrtimit gjyqësor gjykata më dt.19.10.2015, të njëjtën ditë mori dhe publikisht shpalli këtë:

## A K T G J Y K I M

I pandehuri **S. M.**, nga i ati H. dhe nënës M. e vajzërisë S., i lindur më dt.*data e lindjes...* në fshatin D., KK P., tani me vendbanim në fshatin P., Komuna e P., i martuar baba i 3 fëmijëve, ka të kryer shkollën e mesme, i gjendjes së dobët ekonomike, Shqiptarë-Shtetas i Republikës së Kosovës.

## Ë S H T Ë F A J T O R Ë

## S e p s e:

Më datën 16.03.2012, rreth orës 17:27, me qëllim të vjedhjes në pyllin me të cilin qeverisë Agjencia Pyjore e Kosovës, në vendin e quajtur “Maja e Bjeshkëve” të Regjionit Ekonomik Pyjor të Turuqicës, KK Podujevës, i pandehuri ka prerë dhe marrë 24 copë trungje të llojit Bungu, me gjatësi 12 m, me diametër 28-32 cm, me vëllim të përgjithshëm prej 6.66 m<sup>3</sup>, me ç`rast të dëmtuarës Autoritetit Pyjor të Kosovës- zyra në Prishtinë, i ka shkaktuar dëm në vlerë rreth 545 Euro,-

- Më këtë ka kryer veprën penale Vjedhje pylli nga neni 358 par.2 të KPRK-së.

Prandaj, gjykata në bazë të neneve 4,7,17,41, 43, 45, 46 dhe 73 të KPRK-së, si dhe nenit 365 të KPPRK-së, e:

## G J Y K O N

Të pandehurin **S. M.**, e dënon me dënim me burgim në kohëzgjatje prej **3 (tre ) muajsh**, të cilin dënim do ta mbaj pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, si dhe me dënim me gjobë në shumë prej **200 Euro (dyqind euro)**, të cilin dënim obligohet ta paguaj brenda afatit prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Nëse i pandehuri nuk e paguan dënimin me gjobë brenda afatit prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, atëherë dënimi me gjobë do t`i zëvendësohet me dënim burgimi, ashtu që për çdo 20€ (njëzet euro), të papaguara do t`i llogaritet 1(një) ditë burg.

**Detyrohet**, i pandehuri që në emër të shpenzimeve të procedurës penale të paguaj shpenzimet paushallë gjyqësor në shumën prej **20€(njëzet euro)**, të gjitha këto brenda afatit prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

E dëmtuara APK-Zyra në Prishtinë, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest të rregullt juridiko-civil.

## A r s y e t i m

Prokuroria Publike Komunale tani Prokuroria Themelore në Prishtinë, me aktakuzën PP.nr.1881/2011 të dt.21.06.2012, ka akuzuar të pandehurin S. H. M. nga fshati P., Komuna e P., për shkak se ka kryer veprën penale Vjedhje pylli nga neni 285 par.2 të KPK-së.

Lidhur me këtë çështje penale gjykata mbajti seancën e shqyrtimit gjyqësor më dt. 12.10.2015 i cili shqyrtim ka vazhduar edhe në seancën e dt.19.10.2015, në të cilën u dëgjuan Prokurori i Shtetit Enver Krasniqi nga Prokuroria Themelore në Prishtinë, i pandehuri S. M., përfaqësuesi i të dëmtuarës APK-Faik Rama, si dhe dëshmitari Xh.Sh..

Prokurori i shtetit, duke u bazuar në dispozitat e nenit 3 të KPRK-së, për zbatimin e ligjit më të favorshëm ndaj të pandehurit, ka bërë rikualifikimin e veprës penale *Vjedhje pylli nga neni 285 par.2 të KPK-së, në veprën penale Vjedhje pylli nga neni 358 par.2 të KPRK-së*, si ligj ma i favorshëm për palën.

Gjatë shqyrtimit gjyqësor Prokurori i Shtetit Enver Krasniqi nga Prokuroria Themelore në Prishtinë, ka prezantuar aktakuzën i cili në fjalën përfundimtare deklaroi se mbetem në tërësi pran aktakuzës PP.nr.1881/2012 të dt.21.07.2012, kundër të pandehurit S. M., për veprën penale vjedhje pyllit nga neni 358 par.2 të KPRK-së, nga provat të cilat është mbështetur aktakuza dhe posaçërisht nga deklaratata e dëshmitarit Xh. Sh., roje pyllit pranë autoritetit Komuna në Podujevë, e dhënë gjatë këtij shqyrtimit gjyqësor, u vërtetua se i njëjti në cilësinë e rojës së pyllit me dt.16.03.2012, rreth orës 17.27 minuta, në vendin e quajtur Maja e bjeshkëve, në regjionin ekonomik pyjorë në Turuqicë, kishte hasur të pandehurin S. M. duke prerë pyllin në të cilin qeverise autoriteti pyjor Komuna në Podujevë, mbi këtë bazë u vërtetua se në veprimet e të pandehurit S. M., përmbushen të gjitha elementet e veprës penale si në aktakuzë, i propozoj gjykatës që deklaratës së të pandehurit mos t'ia fali besimin sepse e njëjta është e orientuar në drejtim të shmangies së veprës penale të lartcekur andaj, kërkoj nga gjykata ta shpallë fajtorë dhe ta dënoj sipas ligjit.

Përfaqësuesi i autorizuar i palës së dëmtuar Faik Rama në seancën e shqyrtimit gjyqësor në fjalën përfundimtare, ka deklaruar se e mbështesë në tërësi fjalën e prokurorit të shtetit dhe paraqes kërkesën pasurore juridike në lartësinë e demit të shkaktuar.

I akuzuari S. M., në mbrojtjen e tij të dhënë gjatë shqyrtimit gjyqësor e mohoj kryerjen e veprës penale dhe në fjalën përfundimtare deklaroi se nuk është e vërtetë ajo që është këtu në aktakuzë ngase nuk është e vërtetë se unë atë ditë kam prerë dru në pyll.

Pas nxjerrjes së provave, vlerësimit dhe krahasimit të tyre, gjykata në mbështetje të nenit 8 dhe 361 të KPRK-së, vërtetoi gjendjen faktike të përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjendjen e tillë faktike gjykata e vërtetoi nga këto prova: nga deklaratata e dëshmitarit Xh. Sh., roje pylli si dhe nga provat tjera materiale që gjenden në shkresat e lëndës siç janë fletëparaqitja e rojës së pyllit e datës 16.03.2012, Ditari i rojës së pyllit për dt.16.03.2012.

Me vërejtje nga ana e të pandehurit në provat e administruara.

Faktin se me të vërtet i akuzuari S. M. ka vepruar në ndërmarrjen e veprimeve të veprës penale që i vihet në barrë, si në dispozitivin e këtij aktgjykimi, gjykata e vërtetoi nga deklaratata e dëshmitarit Xh. Sh., roje pylli i cili me deklaratën e tij vërtetoi faktin se ne si roje pyllit së pari kemi për obligim ruajtjen e pasurisë e cila na është besuar te rajonit ku jemi caktuar por edhe më gjerë. Në vitin 2012 kam qenë i angazhuar në rajonin e Turuqicës. Lokacioni Maja e Bjeshkëve është në regjionin ekonomik pyjor të Turuqicës, ku me dt.16.03.2012, kam takuar tani të pandehurin S. M. duke prerë dru. Të njëjtin e kam njohur më parë se këtë e kam hasur edhe më parë në pyll duke prerë dru, mirëpo në këtë rast nuk ka qenë

vetëm S., mirëpo kanë qenë edhe disa të tjerë të gjithë me traktorë të vetë, kur kam shkuar në vendin e ngjarjes të gjitha kanë qenë po në të njëjtin vend aty u kam tërhequr të gjithëve vërejtjen e personalisht edhe S. i cili në atë moment me ka thënë se ky vend ku jemi duke prerë dru është jashtë territorit të Kosovës, mirëpo unë atë vend e dije që është pronë e territorit të Kosovës ku të gjithëve u kam marr shënimet dhe të gjithëve u kam bërë fletëparaqitje për prerje-vjedhje pyllit.

Faktin se ditën kritike dëshmitari Xh. Sh.-roje pylli, me të vërtetë e ka hasë të akuzuarin S.M., siç përshkruhet në dispozitiv të aktakuzës e vërtetoi nga deklaratat e tij e dhënë në seancën e shqyrtimit gjyqësor më dt.19.10.2015, në të cilën deklaroi se të njëjtin e kam njohur edhe më parë ngase e kam hasur edhe më parë duke prerë dru.

Prandaj duke u mbështetur në këto fakte dhe prova të vërtetuara në veprimet e të akuzuarit përmbushen të gjitha elementet e veprës penale Vjedhje pylli nga neni 358 par.2 të KPRK-së, pasi që në rastin konkret në veprimet e të akuzuarit janë manifestuar veprime të kundërligjshme, të cilat veprime janë ndërmarrë nga ana e të akuzuarit, për çka gjykata të akuzuarin e shpalli fajtor dhe i shqiptoj dënimin si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, duke besuar se me dënimin e shqiptuar do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me nenin 34 të KPK-së.

Nga provat e administruara pakontestueshëm u vërtetua se i pandehuri Safet Mehanja, me datën 16.03.2012, rreth orës 17:27, me qëllim të vjedhjes, në vendin e quajtur “Maja e Bjeshkëve” në Regjionin Ekonomik Pyjor të Turuqicës, ka prerë dhe marrë 24 copë trungje të llojit Bungu, me gjatësi 12 m, me diametër 28-32 cm, me vëllim të përgjithshëm prej 6.66 m<sup>3</sup>, me ç`rast të dëmtuarës, i ka shkaktuar dëm material.

Gjykata mbrojtjen e të akuzuarit të dhënë gjatë shqyrtimit gjyqësor, në të cilën nuk e pranon se e ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet duke u mbrojtur “se me dt.16.03.2012, kam qenë te shtëpia ime në fshatin Peran”, nuk e pranoi si të vërtetë e konsideroi si qëllim i të akuzuarit për ti ikur përgjegjësisë penale, duke e mohuar kryerjen e veprës penale për të cilën akuzohet, gjykata nuk ia falë besimin deklarimit të tij të dhënë në shqyrtimin gjyqësor se ai nuk e ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet, gjykata nuk ia falë besimin deklarimit të tij sepse me mbrojtjen e tij nuk arriti që të dëshmoi deklarimin dhe pafajësinë e tij, sepse ky deklarim nuk ka mbështetje në asnjë provë të vetme, për këtë gjykata gjeti se i pandehuri është përgjegjës për veprimet penale për të cilën është shpallur fajtor.

Sa i përket propozimit të përfaqësuesit të autorizuar të dëmtuarës, që gjykata ta obligoj të akuzuarin për kompensimin e dëmit të shkaktuar me rastin e kryerjes së veprës penale, gjykata të njëjtin nuk e aprovoi ngase erdhi në përfundim se vlerësimi i shkaktimit të dëmit është bërë nga vetë roja e pyllit i cili është punëtor pranë palës së dëmtuar dhe se nga shkresat e lëndës nuk ka ekspertizë të ekspertit adekuat, andaj vetëm raporti i vlerësimit të dëmit nga punëtorët e palës së dëmtuar ishte për gjykatën provë e pamjaftueshme për ta obliguar të akuzuarin për të bërë kompensimin e dëmit, andaj për këtë arsye vendosi që palën e dëmtuar për realizimin e kërkesës pasurore juridike ta udhëzoi në kontest të rregullt juridiko-civil.

Me rastin e vendosjes së llojit dhe lartësisë së dënimit, Gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat të cilat konform nenit 64 të KPK-së ndikojnë në llojin dhe masën e dënimit, dhe në rastin konkret si rrethana lehtësuese gjeti faktin se është hera e parë që ka ra ndesh me ligjin, sjelljen e tij para gjykatës, gjendjen e tij familjare dhe ekonomike, duke e marrë parasysh shkallën e përgjegjësisë penale si rrethana rënduese gjykata gjeti se edhe më parë ka qenë i dënuar për veprë penale Vjedhje pylli, është recidivist i veprave të ngjashme, sjelljen e tij pas kryerjes së veprës penale, motivin për kryerjen e veprës, gjithashtu pati parasysh shkallën e përgjegjësisë penale të pandehurit, intensitetin e rrezikimit apo dëmtimit të vlerës së mbrojtur në këtë çështje penalo-juridike, andaj gjykata ka shqiptuar dënimin si në dispozitiv të aktgjykimit me bindje se ky dënim është adekuat me shkallën e rrezikshmërisë shoqërore të veprës së

kryer penale dhe shkallën e përgjegjësisë penale të pandehurit dhe se me një dënim të tillë do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me nenin 34 par.1 të KPK-së, që të parandaloj kryesin nga kryerja e veprave penale në të ardhmen të bëjë rehabilitimin e tij, dhe të parandaloj personat e tjerë nga kryerja e veprave të tilla penale.

Vendimi mbi udhëzimin e të dëmtuarit për realizimin e kërkesës pasurore-juridike në kontest civil është marrë në kuptim të nenit 463 par.1 dhe 2 të KPPRK-së.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale u muar në bazë të nenit 450 par.1 dhe 2 pika 2.6 lidhur me nenin 453 par.1 të KPPRK-së.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE PRISHTINË-DEGA PODUJEVË**  
**P.nr.1119/2012 më dt.19.10.2015**

**Gjyqtari :**  
Minir Hoti

**KËSHILLA JURIDIKE:**

Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet Ankesë në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmes kësaj gjykate.